



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



ANALIZË E VOTAVE ME ASISTENCË

ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, 6 TETOR 2019

www.kqz-ks.org | Qershor, 2020

© [2020] - [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve].

Raporti “Analizë e votave me asistencë për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 6 tetor 2019” u hartua nga Komisioni i përkohshëm, në përbërje të zyrtarëve të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e vetme e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës.

www.kqz-ks.org

kqz.sekretariati@kqz-ks.org

Rruga Migjeni, Nr. 21

10 000, Prishtinë

Republika e Kosovës

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	3
I. Metodologjia e hartimit të raportit.....	5
II. VOTIMI ME ASISTENCË - të dhënat e përgjithshme nga Zgjedhjet Lokale të datës 22 tetor 2017.....	6
III. VOTIMI ME ASISTENCË – të dhënat e përgjithshme nga Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 6 tetor 2019.....	8
3.1. Kategorizimi i numrit të votave me asistencë për vendvotim.....	11
3.2. Kategorizimi i numrit të votave me asistencë në vendvotimet që gjenden në zonat urbane dhe në zonat rurale (fshatrave).....	13
IV. TË DHËNAT E VOTUESVE QË KANË VOTUAR ME ASISTENCË.....	14
4.1. Të dhënat e votuesve që kanë votuar me asistencë sipas moshës.....	16
4.2. Të dhënat e votuesve që kanë votuar me asistencë sipas gjinisë.....	17
V. TË DHËNAT E PERSONAVE QË KANË ASISTUAR.....	19
5.1. Të dhënat për moshën dhe gjininë e personave që kanë asistuar.....	19
VI. TË GJETURAT NGA ANALIZA E VOTAVE ME ASISTENCË.....	20
REKOMANDIMET.....	24
<i>SHEMBULL I MIRË (për të dhënat në librat e votimit).....</i>	<i>26</i>
<i>SHEMBULL I KEQ (për të dhënat në librat e votimit).....</i>	<i>28</i>
<i>IMAZHE NGA LIBRAT E VOTIMIT.....</i>	<i>30</i>

Hyrje

Bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e përgjithshme, votuesi i cili është me aftësi të kufizuar ose i cili nuk është në gjendje të shënojë ose të hedh fletëvotimin ose është analfabet, mund të ndihmohet nga një person tjetër i zgjedhur nga votuesi nëse ai kërkon një ndihmë të tillë. Personi i tillë e ndihmon vetëm një votues, i cili nuk është anëtar i Këshillit të vendvotimit ose vëzhgues i akredituar¹.

Ndërsa, sipas Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2013, ndihma që i jepet votuesve që kërkojnë të votojnë me asistencë duhet të monitorohet nga afër nga kryesuesi i KVV-së ose zëvendësi i tij².

Të gjitha votat me asistencë evidentohet në Librin e Votimit në secilin vendvotim nga Kryesuesi i cili duhet të mbajë evidencë të ndihmësve, sepse vetëm njëherë ju lejohet që të ndihmojnë³.

Sipas Raportit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019, nga vëzhguesit janë evidentuar 42,571 raste të rregullta të asistimit të votuesve, ku në këtë raport komuna me numrin më të madh të raste të votimit me asistencë është komuna e Prizrenit, me mbi 3 mijë votues të raportuar si votues me asistencë⁴.

Në Raportin përfundimtar të Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të Bashkimit Evropian, vëzhguesit kanë vërë në pah ndihmën e tepërt për votuesit, e cila u vëzhgua në shumë nga vendvotimet e vëzhguara. Sipas këtij raporti, numri i votimit me asistencë, në disa vendvotime shkon deri në 22 për qind⁵.

Edhe për proceset e kaluara zgjedhore, rrjeti i organizatave jo qeveritare “Demokracia në Veprim” në raportet e publikuara japin shifra për votimin me asistencë.

¹ Ligji nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 89.5.

² Rregulla Zgjedhore Nr. 09/2013 Votimi, Numërimi në vendvotim dhe menaxhimi i Qendrës së Votimit, neni 15.5.

³ Doracaku i Procedurave të Votimit dhe Numërimit, faqe 39.

⁴ Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve – Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019, faqe 36.

⁵ Bashkimi Evropian, Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, KOSOVA 2019, Raporti Përfundimtar, Zgjedhjet e parakohshme parlamentare, 6 tetor 2019, faqe 5

(https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/eueomkosovo2019_finalreport_al_withcovers.pdf).

Në Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës të vitit 2014, 40,561 votues kishin votuar me asistencë⁶.

Ndërsa, nga po e njëjta organizatë, për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të vitit 2017 në raportin e publikuar, rreth 31,477 votues kishin votuar me asistencë⁷.

Andaj, me qëllim të identifikimit të numrit të saktë të votuesve që kanë votuar me asistencë dhe identifikimit të dyshimeve për keqpërdorim të kësaj mënyre të votimit, përmes këtij raporti, janë paraqitur të dhënat, si rezultat i leximit i të gjithë librave të votimit për çdo vendvotim, në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, ku për një përqindje të caktuar të vendvotimeve, janë nxjerrë të dhënat e personave që kanë asistuar dhe votuesve që kanë votuar me asistencë.

Ky raport përfshinë të dhënat e nxjerra nga librat e votimit për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 6 tetor 2019, në të cilin është përfshirë numri total i rasteve të votimit me asistencë, moshë dhe gjinia për votuesit që kanë votuar me asistencë, të dhënat për personat që kanë asistuar, duke përfshirë moshën dhe gjininë.

Raporti gjithashtu vë në pah edhe rastet e personave që kanë asistuar më shumë se një herë, qoftë brenda të njëjtit vendvotim, qoftë në vendvotime të ndryshme brenda të njëjtës komunë.

Përveç që ky raport përmban të dhëna të detajuara për votimin me asistencë për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 6 tetor 2019, raporti përfshinë edhe votat me asistencë për çdo komunë për Zgjedhjet Lokale të datës 22 tetor 2017.

⁶ http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/05/DNV-Monitorimi-Zgjedhjet-Kuvend-Kosoves-2014_shq.pdf

⁷ <http://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2018/01/132-dnv-raporti-perfundimtar-zgjedhjet-parlamentare-2017-alb.pdf>

I. Metodologjia e hartimit të raportit “Analizë e votave me asistencë për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019”

Në hartimin e raportit “Analizë e votave me asistencë për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019” komisioni i përkohshëm i Sekretariatit të KQZ-së, duke filluar nga muaji prill, i vitit 2020, në hartimin e këtij raporti, ka ndjekur këtë metodë:

1. Nxjerrja e të dhënave të numrit të votave me asistencë:

- Të dhënat për numrin e votave me asistencë janë nxjerrë nga librat e votimit për çdo vendvotim, për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.
- Të dhënat për numrin e votave me asistencë janë nxjerrë për 2,536 vendvotimeve, apo për 99.5% të vendvotimeve.
- Të dhënat për numrin e votave me asistencë janë paraqitur për çdo komunë, të cilat janë shprehur në përqindje, duke marrë për bazë numrin e votuesve që kanë votuar brenda Kosovës, në secilin vendvotim.

2. Nxjerrja e të dhënave për votuesit që kanë votuar me asistencë

- Të dhënat e votuesve që kanë votuar me asistencë, janë nxjerrë për çdo komunë të Republikës së Kosovës, duke përzgjedhur librat e votimit për çdo të katërtin (4) vendvotim, që i bie se të dhënat janë nxjerrë nga 647 vendvotime, ose shprehur në përqindje i bie që të dhënat për votuesit me asistencë, janë nxjerrë nga 25.5% të vendvotimeve.
- Të dhënat e votuesve që kanë votuar me asistencë, janë paraqitur sipas grup moshave dhe sipas gjinisë, duke i lidhur të dhënat personale me Listën përfundimtare të votuesve për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019.

3. Nxjerrja e të dhënave për personat që kanë asistuar

- Të dhënat e personave që kanë asistuar janë nxjerrë për çdo komunë të Republikës së Kosovës, duke përzgjedhur librat e votimit për çdo të katërtin (4) vendvotim, që i bie se të dhënat janë nxjerrë nga 647 vendvotime ose shprehur në përqindje i bie që të dhënat për personat që kanë asistuar, janë nxjerrë nga 25.5% të vendvotimeve.
- Të dhënat e personave që kanë asistuar, janë paraqitur sipas grup moshave dhe sipas gjinisë, duke i lidhur të dhënat personale me Listën përfundimtare të votuesve për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019.

II. VOTIMI ME ASISTENCË – të dhënat e përgjithshme nga Zgjedhjet Lokale të datës 22 tetor 2017

Në vitin 2018, u pat hartuar raporti për analizën e votave me asistencë për Zgjedhjet Lokale të datës 22 tetor 2017, në të cilin raport, u patën përfshirë të dhënat për numrin e përgjithshëm të votuesve që kanë votuar me asistencë dhe të dhënat për personat që kanë asistuar.

Nga nxjerrja e të dhënave prej librave të votimit për votat me asistencë, për votuesit që kanë votuar në Zgjedhjet Lokale të datës 22 tetor 2017:

- Nga 811,717 votues që kanë votuar, 58,584 votues kanë votuar me asistencë ose shprehur në përqindja i bie që 7,22% e votuesve kanë votuar me asistencë.

Të dhënat për numrin e votuesve që kanë votuar me asistencë, janë nxjerrë për 2,461 vendvotimeve (nga 2,505 vendvotime gjithsejtë) shprehur në përqindje i bie që të dhënat janë nxjerrë për 98.24% të vendvotimeve.

Tabela 1. Të dhënat e shprehura në përqindje për numrin e votuesve që kanë votuar me asistencë për çdo komunë.

Kodi Komunal	Komunat	Numri i Votuesve që kanë votuar	Numri i Votave me asistencë	Përqindja %
01	Deçan	16330	1852	11.34%
02	Gjakovë	42643	3138	7.36%
03	Glllogoc	24141	1717	7.11%
04	Gjilan	46210	3316	7.18%
05	Dragash	14453	715	4.95%
06	Istog	18830	1876	9.96%
07	Kaçanik	16356	1816	11.10%
08	Klinë	18148	1908	10.51%
09	Fushë Kosovë	15576	1257	8.07%
10	Kamenicë	17777	2221	12.49%
11	Mitrovicë e Jugut	31088	2021	6.50%
12	Leposaviq	8092	425	5.25%
13	Lipjan	29022	2385	8.22%
14	Novobërdë	5364	669	12.47%
15	Obiliq	12255	1010	8.24%
16	Rahovec	23466	1940	8.27%

17	Pejë	43733	2996	6.85%
18	Podujevë	39311	2637	6.71%
19	Prishtinë	87459	3074	3.51%
20	Prizren	67106	4108	6.12%
21	Skenderaj	16886	761	4.51%
22	Shtime	13069	1316	10.07%
23	Shtërpçë	7620	665	8.73%
24	Suharekë	28743	2011	7.00%
25	Ferizaj	51193	4014	7.84%
26	Viti	20979	2033	9.69%
27	Vushtrri	31296	1983	6.34%
28	Zubin Potok	3821	191	5.00%
29	Zveçan	4191	114	2.72%
30	Malishevë	22335	2258	10.11%
31	Junik	2507	392	15.64%
32	Mamushë	2518	20	0.79%
33	Hani i Elezit	5017	546	10.88%
34	Graçanicë	8189	318	3.88%
35	Ranillug	3035	220	7.25%
36	Partesh	2622	275	10.49%
37	Kllokot	2334	257	11.01%
38	Mitrovicë e Veriut	8002	129	1.61%
		811,717	58,584	7.22%

Pesë komunat me përqindjen më të vogël të numrit të votave me asistencë, në Zgjedhjet Lokale të datës 22 tetor 2017:

- Mamusha me 0.79%, Mitrovica e Veriut me 1.61%, Zveçani me 2.72%, Prishtina me 3.51% dhe Graçanica me 3.88%.

Pesë komunat me përqindjen më të madhe të numrit të votave me asistencë, në Zgjedhjet Lokale të datës 22 tetor 2017:

- Juniku me 15.64%, Kamenicë me 12.49%, Novobërdë me 12.47%, Deçan me 11.34% dhe Kaçanik me 11.10%.

III. VOTIMI ME ASISTENCË – të dhënat e përgjithshme nga Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 6 tetor 2019

Numri i votuesve që kanë votuar me asistencë në Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 6 tetor 2019, rezulton të jetë rreth 2,700 rastesh më pak të numrit të votuesve që kanë votuar me asistencë nga Zgjedhjet Lokale të datës 22 tetor 2017.

Sipas të dhënave që janë marrë nga librat e votimit për votat me asistencë dhe sipas të dhënave të numrit të përgjithshme të votuesve që kanë votuar në vendvotime në Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 6 tetor 2019, rezulton se:

- Nga 826,916 votues që kanë votuar në vendvotime në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës⁸, 55,961 votues kanë votuar me asistencë.
- Shprehur në përqindje, i bie që 6,76% e votuesve kanë votuar me asistencë.

Të dhënat që janë nxjerrë për numrin e votuesve që kanë votuar me asistencë, i përkasin: 2,536 vendvotimeve nga 2,547 vendvotime gjithsejtë, ose shprehur në përqindje i bie që të dhënat e votimit me asistencë, janë nxjerrë për 99.5% të vendvotimeve.


Tabela 2. Të dhënat e shprehura në përqindje për numrin e votuesve që kanë votuar me asistencë për çdo komunë.

Kodi Komunal	Komunat	Numri i votuesve që kanë votuar për çdo komunë (në secilin vendvotim)	Numri i votave me asistencë për çdo komunë	Përqindja %
01	Deçan	16282	1932	11.86%
02	Gjakovë	42128	2862	6.79%
03	Glllogoc	23728	1544	6.50%
04	Gjilan	46468	2927	6.29%
05	Dragash	13050	629	4.81%
06	Istog	18859	1843	9.77%
07	Kaçanik	15210	1467	9.64%
08	Klinë	17192	1620	9.42%
09	Fushë Kosovë	17746	1295	7.29%
10	Kamenicë	16182	1735	10.72%
11	Mitrovicë e Jugut	32747	1971	6.01%

⁸ <http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2019/11/6.Statistikat-sipas-komunave-1.pdf>

12	Leposaviq	7898	247	3.12%
13	Lipjan	28656	2297	8.01%
14	Novobërdë	4811	331	6.88%
15	Obiliq	12221	941	7.69%
16	Rahovec	21674	1914	8.83%
17	Pejë	45175	2991	6.62%
18	Podujevë	39769	2549	6.40%
19	Prishtinë	103691	4012	3.86%
20	Prizren	66493	3876	5.82%
21	Skenderaj	20844	1302	6.24%
22	Shtime	12590	1198	9.51%
23	Shtërpçë	7466	573	7.67%
24	Suharekë	26797	1862	6.94%
25	Ferizaj	52175	3591	6.88%
26	Viti	19826	1914	9.65%
27	Vushtrri	32975	2201	6.67%
28	Zubin Potok	4790	113	2.35%
29	Zveçan	4660	112	2.40%
30	Malishevë	21611	2205	10.20%
31	Junik	2056	259	12.59%
32	Mamushë	1999	13	0.65%
33	Hani i Elezit	3675	379	10.31%
34	Graçanicë	9460	321	3.39%
35	Ranillug	2823	138	4.88%
36	Partesh	2174	131	6.02%
37	Kllokot	1939	200	10.31%
38	Mitrovicë e Veriut	9076	466	5.13%
		826,916	55,961	6.76%

PARAQITJA GRAFIKE: Të dhënat e shprehura në përqindje të votave me asistencë sipas renditjes së komunave, nga përqindja më e madhe, në përqindjen më të vogël.



Në diagramin e më sipërm janë paraqitur të dhënat e shprehura në përqindje të votave me asistencë, duke filluar nga komuna ku numri i votave me asistencë është e shprehur në përqindjen më të ulët dhe duke përfunduar në komunën ku numri i votave me asistencë është e shprehur në përqindjen më të lartë.

Të dhënat e shprehura në përqindje për çdo komunë të Republikës së Kosovës, janë llogaritur në raport me numrin e votuesve që kanë votuar në ditën e zgjedhjeve brenda vendvotimeve për çdo komunë.

Pesë komunat me përqindjen më të ulët të numrit të votave me asistencë, janë:

- Komuna e Mamushës me 0.65%, Komuna e Zubin Potokut me 2.35%, Komuna e Zveçanit me 2.40%, Komuna e Leposaviqit me 3.12% dhe Komuna e Graçanicës me 3.39%.

Pesë komunat me përqindjen më të lartë të numrit të votave me asistencë, janë:

- Komuna e Junikut me 12.59%, Komuna e Deçanit me 11.86%, Komuna e Kamenicës me 10.76%, Komuna e Klllokotit me 10.31%, dhe Komuna e Hanit të Elezit me 10.31%.

3.1. Kategorizimi i numrit të votave me asistencë për vendvotime

Sa i përket kategorizimit të numrit të votave me asistencë për vendvotime, në tabelën e më poshtme janë paraqitur të dhënat për numrin e votave me asistencë në raport me numrin e vendvotimeve, duke e kategorizuar se në sa vendvotime, votuesit kanë votuar me asistencë, duke filluar prej 0 deri në 80 vota me asistencë.

Prej 0 deri 80 vota me asistencë	Numri i votave me asistencë për vendvotime
0 vota me asistencë	129 vendvotime
Prej 1 deri ne 10 vota me asistencë	445 vendvotime
Prej 11 deri ne 20 vota me asistencë	670 vendvotime
Prej 21 deri në 30 vota me asistencë	652 vendvotime
Prej 31 deri në 40 vota me asistencë	380 vendvotime
Prej 41 deri në 50 vota me asistencë	186 vendvotime

Prej 51 deri në 60 vota me asistencë	55 vendvotime
Prej 61 deri në 70 vota me asistencë	16 vendvotime
Prej 71 deri në 80 vota me asistencë	14 vendvotime

Në Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës ekzistojnë disa vendvotime, në të cilat numri i votuesve që kishin votuar me asistencë kalon mbi 20% të numrit të përgjithshëm të votuesve që kishin votuar në këto vendvotime.

Të dhënat për disa vendvotime për këto raste, janë si në vijim:

- Në komunën e Kamenicës, në vendvotimin 1032D/02D, nga 619 votues të regjistruar në këtë vendvotim, kishin votuar vetëm 278 votues. Prej këtyre 278 votues, 60 votues kishin votuar me asistencë. Shprehur në përqindje, i bie që në këtë vendvotim, 21.58% e votuesve kishin votuar me asistencë.
- Në Komunën e Klinës, në vendvotimin 0803C/02R, 350 votues të regjistruar në këtë vendvotim, 80 prej tyre kanë votuar me asistencë, që në përqindje i bie që në këtë vendvotim, 22.85% e votuesve kanë votuar me asistencë.
- Në komunën e Prizrenit, në vendvotimin 2020A/02R, nga 746 votues me të regjistruar në këtë vendvotim, kishin votuar vetëm 322 votues. Prej këtyre 322 votues, 76 votues kishin votuar me asistencë. Shprehur në përqindje, i bie që në këtë vendvotim, 23.60% e votuesve kishin votuar me asistencë.
- Në komunën e Malishevës, në vendvotimin 3048A/01D, nga 714 votues me të regjistruar në këtë vendvotim, kishin votuar vetëm 267 votues. Prej këtyre 267 votues, 78 votues kishin votuar me asistencë. Shprehur në përqindje, i bie që në këtë vendvotim, 29.21% e votuesve kishin votuar me asistencë.


Në Raportin Përfundimtar të Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të Bashkimit Evropian për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 2019, theksohet ndihma e tepërt e votuesve u vëzhgua në shumë vendvotime të vizituara, ku në disa vendvotime numrin e votuesve që kanë votuar me asistencë shkon deri në 22 për qind⁹.

⁹ Bashkimi Evropian, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve, Kosova 2018, Raporti Përfundimtar për Zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2019, faqe 39, paragrafi i tretë.

3.2. Kategorizimi i numrit të votave me asistencë në vendvotimet që gjenden në zonat urbane dhe në zonat rurale (fshatra)

Sa i përket kategorizimi të votave me asistencë sipas vendvotimeve që gjenden në zonat urbane dhe sipas vendvotimeve që gjenden në zonat rurale apo fshatra, në komunat e Republikës së Kosovës, rezultojnë se:

- a) Në 944 vendvotime që gjenden në zonat urbane të qyteteve apo komunave: 17,463 votues kanë votuar me asistencë.
- b) Në 1,592 vendvotime që gjenden në zonat rurale apo fshatra: 38,498 votues kanë votuar me asistencë.



IV. TË DHËNAT E VOTUESVE QË KANË VOTUAR ME ASISTENCË

Të dhënat për votuesit që kanë votuar me asistencë dhe të dhënat për personat që kanë asistuar, janë nxjerrë prej 647 libra të votimit nga 2,536 vendvotimeve gjithsejtë. Shprehur në përqindje i bie që të dhënat janë nxjerrë për 25.5% të librave të votimit.

Librat e votimit janë përzgjedhur duke i ndarë për çdo të katërtin (4) vendvotim, për secilën komunë të Republikës së Kosovës.

Nga 647 libra të votimit apo vendvotime, të dhënat për moshën dhe gjininë janë nxjerrë për 9,074 votues që kanë votuar me asistencë. Shprehur në përqindje, i bie që këto të dhëna janë nxjerrë për 16.21% të numrit të përgjithshëm të votave me asistencë (55,961).

Tabela 3. Të dhënat për numrin e librave të votimit për çdo komunë, nga të cilat janë nxjerrë të dhënat për votuesit që kanë votuar me asistencë dhe për personat që kanë asistuar.

Kodi Komunal	Komunat	Numri i vendvotimeve/ Librat e votimit	Librat e votimit/ për çdo të katërtin vendvotim
01	Deçan	54	19
02	Gjakovë	141	35
03	Glllogoc	72	18
04	Gjilan	129	33
05	Dragash	60	15
06	Istog	63	16
07	Kaçanik	47	12
08	Klinë	64	16
09	Fushë Kosovë	47	12
10	Kamenicë	56	14
11	Mitrovicë e Jugut	104	26
12	Leposaviq	31	8
13	Lipjan	80	20
14	Novobërdë	22	6
15	Obiliq	35	9
16	Rahovec	80	21
17	Pejë	138	34
18	Podujevë	108	27
19	Prishtinë	247	62

20	Prizren	218	55
21	Skenderaj	77	19
22	Shtime	35	9
23	Shtërpçë	21	6
24	Suharekë	89	22
25	Ferizaj	146	36
26	Viti	67	17
27	Vushtrri	96	24
28	Zubin Potok	15	4
29	Zveçan	13	4
30	Malishevë	74	19
31	Junik	7	2
32	Mamushë	5	2
33	Hani i Elezit	12	3
34	Graçanicë	32	8
35	Ranillug	10	3
36	Partesh	7	2
37	Kllokot	7	2
38	Mitrovicë e Veriut	27	7
TOTALI		2,536	647

4.1. Të dhënat e votuesve që kanë votuar me asistencë sipas moshës


Të dhënat e votuesve që kanë votuar me asistencë, të cilat janë nxjerrë nga librat e votimit dhe pastaj që janë krahasuar me të dhënat sipas Listës përfundimtare të votuesve për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datën 6 tetor 2019, rezulton se, prej 9,074 votues që kanë votuar me asistencë:

- a) 4,430 votues që kanë votuar me asistencë, janë të moshës prej 18 vjeç deri në moshën 65 vjeç, dhe
- b) 4,644 votues që kanë votuar me asistencë, janë të moshës mbi 65 vjeç.

Sipas të dhënave të nxjerra nga librat e votimit, votuesi më i vjetër, që ka votuar me asistencë, i përket gjinisë femërore, e moshës 108 vjet, e lindur në vitin 1911. Ndërsa, gjashtëdhjetë e pesë votues, të cilët kanë votuar me asistencë, në Zgjedhjet e

parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 6 tetor 2019, kanë pasur 18 vjeç.

Paraqitja grafike: Votuesit që kanë votuar me asistencë nga moshë 18 vjeç deri në moshën 65 vjeç, dhe mbi 65 vjeç.



Moshë mesatare për 9,074 votues që kanë votuar me asistencë është 62 vjeç.

Tabela 4: Të dhënat për numrin e votuesve sipas moshës, të ndara në kategori dhe shprehur në përqindje.

Moshë prej/ deri	Numri i votuesve	Përqindja
18 deri 30 vjeç	546	6%
31 deri 40 vjeç	547	6%
41 deri 50 vjeç	741	8.16%
51 deri 60 vjeç	1,432	15.78%
61 deri 65 vjeç	1,164	12.82%
Mbi 65 Vjeç	4,644	51.17%

Sa i përket kategorisë së fundit (votuesit që kanë votuar me asistencë) mbi moshën 65 vjeç, më poshtë janë të paraqitura të dhënat sipas pesë (5) nënkategorive:

- Nga moshë 65 deri në 70 vjeç, janë: 1,625 votues që kanë votuar me asistencë,

- Nga mosha 71 deri në 80 vjeç, janë: 2,434 votues që kanë votuar me asistencë,
- Nga mosha 81 deri në 90 vjeç, janë: 820 votues që kanë votuar me asistencë,
- Nga mosha 91 deri 99 vjeç, janë: 40 votues që kanë votuar me asistencë, dhe
- Mbi moshën 100 vjeç: 3 votues.

4.2. Të dhënat e votuesve që kanë votuar me asistencë sipas gjinisë

Të dhënat e votuesve që kanë votuar me asistencë, të cilat janë nxjerrë nga librat e votimit dhe pastaj që janë krahasuar me të dhënat sipas Listës përfundimtare të votuesve për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datën 6 tetor 2019, rezulton se, prej 9,074 votues që kanë votuar me asistencë:

- 2,488 votues janë të gjinisë mashkullore, ose 27.41%, dhe
- 6,586 votues janë të gjinisë femërore, ose 72.58%.

Tabela 5: Të dhënat për numrin e votuesve sipas gjinisë për çdo komunë dhe Numri i moshës, të ndara në kategori dhe shprehur në përqindje.

Kodi Komunal	Komunat	Gjinia M	Gjinia F	Numri i votuesve që kanë votuar me asistencë për çdo komunë
01	Deçan	106	293	399
02	Gjakovë	172	328	500
03	Glllogoc	64	91	155
04	Gjilan	144	419	563
05	Dragash	17	60	77
06	Istog	88	232	320
07	Kaçanik	34	133	167
08	Klinë	61	197	258
09	Fushë Kosovë	87	172	259
10	Kamenicë	87	235	322
11	Mitrovicë e Jugut	93	326	419
12	Leposaviq	14	23	37
13	Lipjan	91	206	297
14	Novobërdë	1	1	2
15	Obiliq	50	161	211
16	Rahovec	91	95	186
17	Pejë	161	466	627
18	Podujevë	128	376	504

19	Prishtinë	142	444	586
20	Prizren	104	224	328
21	Skenderaj	46	95	141
22	Shtime	52	121	173
23	Shtërpcë	19	24	43
24	Suharekë	89	306	395
25	Ferizaj	161	462	623
26	Viti	66	212	278
27	Vushtrri	94	330	424
28	Zubin Potok	2	2	4
29	Zveçan	13	18	31
30	Malishevë	139	360	499
31	Junik	15	51	66
32	Mamushë	0	0	0
33	Hani i Elezit	10	42	52
34	Graçanicë	13	16	29
35	Ranillug	5	27	32
36	Partesh	6	13	19
37	Klllokot	7	3	10
38	Mitrovicë e Veriut	16	22	38
TOTALI		2,488	6,586	9,074

V. TË DHËNAT E PERSONAVE QË KANË ASISTUAR

Të dhënat për personat që kanë asistuar, po ashtu janë nxjerrë nga 647 libra të votimit (vendvotime). Numri total i personave që kanë asistuar, të nxjerra nga librat e votimit janë gjithsejtë për 10,244 persona që kanë asistuar Shprehur në përqindje i bie që të dhënat janë nxjerrë për 18.30% të numrit të përgjithshëm të personave që kanë asistuar (55,961).

Ky numër është krahasuar me numrin total të votave me asistencë, sepse jo të gjitha këto raste, janë raste individuale të asistimit, sepse nga kjo analizë, është konstatuar se ka raste kur personat kanë asistuar më shumë se një herë, gjë që është në kundërshtimit me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

5.1. Të dhënat për moshën dhe gjininë e personave që kanë asistuar

Mosha mesatare për 10,244 persona që kanë asistuar është 41 vjeç.

Mosha prej/ deri	Numri i asistuesve	Përqindja
18 deri 30 vjeç	2,832	27.64%
31 deri 40 vjeç	2,522	24.91%
41 deri 50 vjeç	2,271	22.16%
51 deri 60 vjeç	1,269	12.38%
61 deri 65 vjeç	453	4.42%
Mbi 65 Vjeç	640	6.24%

Sa i përket gjinisë së personave që kanë asistuar në votim:

- 7,016 persona që kanë asistuar, janë të gjinisë mashkullore, ose 68.48%, dhe
- 3,228 persona që kanë asistuar, janë të gjinisë femërore, ose 31.51%.

VI. TË GJETURAT NGA ANALIZA E VOTAVE ME ASISTENCË

Nga të dhënat e analizuar të personave që kanë asistuar, rezulton se:

1. Në Komunën e Istogut, në vendvotimin 0602C/04D, personi që ka asistuar nuk ka qenë shtetas i Republikës së Kosovës.
2. Një qind e shtatë (107) persona, në Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datën e 6 tetor 2019 kanë asistuar më shumë se një herë:
 - 65 persona kanë asistuar më shumë se një herë në të njëjtin vendvotim. Nga Kryesuesit e Këshillave të Vendvotimit, personit të caktuar iu është lejuar që të asistoj në të njëjtën kohë për dy persona.
 - 36 persona kanë asistuar më shumë se një herë në vendvotime të ndryshme.
 - 3 persona kanë asistuar më shumë se një herë në komuna të ndryshme.
 - 3 persona kanë asistuar tri herë.
3. Në komunën e Glllogocit, në vendvotimin 0306E/02R, 16 persona që kanë asistuar në këtë vendvotim, kanë mbiemër të njëjtë.
4. Në komunën e Prizrenit, në vendvotimin 2015A/02R, 23 persona të të njëjtit mbiemër, kanë asistuar për votim 23 votues, të cilët kanë të njëjtin mbiemër me personat që kanë asistuar.
5. Në Komunën e Malishevës, në vendvotimin 3048A/01D, 46 persona të të njëjtit mbiemër, kanë asistuar në votim 46 votues, të cilët kanë të njëjtin mbiemër me personat që kanë asistuar.
6. Nga analiza e librave të votimit për të dhënat e personave që kanë asistuar, nëntëmbëdhjetë (19) persona që kanë asistuar, kanë qenë nën moshën 18 vjeçare.
 - Në komunën e Prizrenit, në vendvotimin 2042A/12R, personi që ka asistuar, ka qenë e moshës dymbëdhjetë (12) vjeçare.

- Në komunën e Prizrenit, në vendvotimin 2055A/01R, personi që ka asistuar, ka qenë e moshës trembëdhjetë (13) vjeçare.
7. Në komunën e Prishtinës, në vendvotimin 1915E/05R, personi që ka asistuar në këtë vendvotim, ka asistuar me pasaportë franceze, ku është theksuar në librin e votimit.
 8. Njëqind e dyzet e nëntë (149) persona që kanë asistuar, nuk kanë qenë votues në listën përfundimtare të votuesve, në komunat ku kanë asistuar¹⁰.

¹⁰ 9 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Deçanit. 6 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Gjakovës. 3 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Glllogocit. 7 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Gjilanit. 1 person që kanë asistuar ka qenë votues i një komune tjetër, ka votuesin e komunës së Dragashit. 17 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Istogut. 1 person që kanë asistuar ka qenë votues i një komune tjetër, ka votuesin e komunës së Kaçanikut. 1 person që kanë asistuar ka qenë votues i një komune tjetër, ka votuesin e komunës së Klinës. 6 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Fushë Kosovës. 3 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Kamenicës. 3 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Kamenicës. 12 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Mitrovicës së Jugut. 1 person që kanë asistuar ka qenë votues i një komune tjetër, ka votuesin e komunës së Leposaviqit. 3 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Lipjanit. 1 person që kanë asistuar ka qenë votues i një komune tjetër, ka votuesin e komunës së Novobërdës. 4 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Obiliqit. 3 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Rahovecit. 5 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Pejës. 2 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Podujevës. 15 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Prishtinës. 1 person që kanë asistuar ka qenë votues i një komune tjetër, ka votuesin e komunës së Prizrenit. 9 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Skenderajt. 2 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Shtimes. 2 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Shtërpçës. 4 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Suharekës. 4 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Ferizajt. 7 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Vitisë. 8 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Vushtrrisë. 1 person që kanë asistuar ka qenë votues i një komune tjetër, ka votuesin e komunës së Zubin Potokut. 2 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Zveçanit. 5 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Malishevës. 1 person që kanë asistuar ka qenë votues i një komune tjetër, ka votuesin e komunës së Junikut. 3 persona që kanë asistuar kanë qenë votues të komunave tjera, të cilët kanë asistuar votuesit e komunës së Mitrovicës së Veriut.

9. Një pjesë e konsiderueshme e librave të votimit nuk përmbajnë të dhënat personale të personave që kanë asistuar dhe të votuesve që kanë votuar me asistencë, ose përmbajnë vetëm të dhënat personale të personave që kanë asistuar por jo edhe të votuesve që kanë votuar me asistencë, ose anasjelltas.

SHEMBULL:

- Në Komunën e Deçanit, nga 54 libra të votimit gjithsejtë, në 7 libra të votimit, të dhënat personale ose janë marrë për vetëm personat që kanë asistuar, ose vetëm për votuesit që kanë asistuar, ose janë shkruar emrat dhe mbiemrat e personave që kanë asistuar dhe votuesve që kanë votuar me asistencë, pa numra personal,
- Në Komunën e Dragashit, nga 59 libra të votimit gjithsejtë, në 11 libra të votimit, të dhënat personale ose janë marrë për vetëm personat që kanë asistuar, ose vetëm për votuesit që kanë asistuar, ose janë shkruar emrat dhe mbiemrat e personave që kanë asistuar dhe votuesve që kanë votuar me asistencë, pa numra personal,
- Në Komunën e Kamenicës, nga 56 libra të votimit gjithsejtë, në 10 libra të votimit, të dhënat personale ose janë marrë për vetëm personat që kanë asistuar, ose vetëm për votuesit që kanë asistuar, ose janë shkruar emrat dhe mbiemrat e personave që kanë asistuar dhe votuesve që kanë votuar me asistencë, pa numra personal,
- Në Komunën e Obiliqit, nga 35 libra të votimit gjithsejtë, në 5 libra të votimit, të dhënat personale ose janë marrë për vetëm personat që kanë asistuar, ose vetëm për votuesit që kanë asistuar, ose janë shkruar emrat dhe mbiemrat e personave që kanë asistuar dhe votuesve që kanë votuar me asistencë, pa numra personal,
- Në Komunën e Prizrenit, nga 220 libra të votimit gjithsejtë, në 71 libra të votimit, të dhënat personale ose janë marrë për vetëm personat që kanë asistuar, ose vetëm për votuesit që kanë asistuar, ose janë shkruar emrat dhe mbiemrat e personave që kanë asistuar dhe votuesve që kanë votuar me asistencë, pa numra personal.

- ✓ Bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, Neni 89.5, Votuesi i cili është me aftësi të kufizuar në atë mënyrë që nuk është në gjendje të shënojë ose hedh fletëvotimin, ose është analfabet mund të ndihmohet që të votojë nga një person i zgjedhur nga votuesit nëse ai kërkon një ndihmë të tillë. Personi i tillë e ndihmon vetëm një votues.
- ✓ Në librat e votimit, nga të cilat janë nxjerrë dhe krahasuar të dhënat për personat që kanë asistuar, janë identifikuar një sërë rastesh kur personat kanë asistuar më shumë se një herë, brenda një vendvotimi, duke përfshirë asistimin për dy persona të një pas njëshëm, me ç' rast një gjë e tillë është lejuar nga Këshilli i Vendvotimit, gjë që përbën shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës.
- ✓ Ndihmësi ka të drejtë të ndihmojë vetëm një herë. Doracakun e Procedurave të Votimit dhe Numërimin për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019, faqe 16.



Nëse votuesi kërkon ndihmë për shkak se nuk din shkrim dhe lexim dhe nuk është në gjendje të shënojë fletëvotimin në kabinë, udhëzohet ta gjejë një person me DI jashtë vendvotimit për ta ndihmuar.

Kryesuesi i KVV-së shenon të dhënat personale të asistuesit dhe të votuesit të asistuar në Librin e Votimit dhe kohën.

- ✓ Shënimi i të dhënave personale të personit që ka asistuar dhe votuesit në libra të votimit, i pet si udhëzim në Doracakun e Procedurave të Votimit dhe Numërimin, për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019, në faqen nr. 16 – “Kryesuesi i KVV-së shënontë dhënat personale të asistuesit dhe të votuesit të asistuar në Librin e Votimit dhe kohën”.

REKOMANDIMET


1.	Në rregullën zgjedhore duhet të përfshihet që në Libër të votimit të evidentohen të dhënat e personit që asiston dhe të dhënat e votuesit që kërkon të votojë me asistencë.
2.	Në librin e votimit duhet të dizajnohet tabela që përmban të dhënat që duhet të plotësohen nga kryesuesi i vendvotimit, si: Emrin, mbiemrin dhe numrin personal të asistuesit. Emrin, mbiemrin dhe numrin personal të votuesit (të asistuarit), dhe arsyet e votimit me asistencë. Tabela duhet të dizajnohet në të paktën në katër faqet e fundit të librit të votimit.
3.	Në çdo qendër të votimit duhet të dizajnohen dhe sigurohen kabina të votimit në dimensione të posaçme për votuesit me aftësi të kufizuar, ku do të shmangej votimi me asistencë për këtë kategori votuesish.
4.	Në çdo vendvotim të vendosen posterë njoftues për mos keqpërdorimin e votimit me asistencë dhe informatat tjera për përgjegjësi penale për personat që asistojnë më shumë se një herë.
5.	Kryesuesit e vendvotimeve të informohen se cili është numri personal i identifikimit dhe të mos shënohen numrat serik të letërnjoftimeve si e dhënë për personin që asiston ose për votuesin që voton me asistencë.
6.	<p>Në Doracakun e Procedurave të Votimit dhe Numërimit për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në faqen 16 udhëzon Kryesuesin e KVV-së që të shënoj të dhënat personale të asistuesit dhe të votuesit të asistuar në Librin e Votimit dhe kohën. Ndërsa, në po të njëjtin dokument, në faqen 39, tek pjesa: Votimi me asistencë: “Rastet e votimit me asistencë shkruhen në libër të votimit nga Kryesuesi, i cili duhet të mbajë evidencë të ndihmësve, sepse vetëm njëherë ju lejohej të ndihmojnë”.</p> <p>Pra, duhet që doracakun, për pjesën e votimit me asistencë, të merret për bazë udhëzimi sikurse në faqen 16, që Kryesuesit e</p>

	KVV-së të shënojnë të dhënat personale të personave që kanë asistuar dhe të dhënat personale të votuesve që kanë votuar me asistencë.
7.	Kryesuesi i këshillit të vendvotimit duhet ta njoftoj personin që asiston, se ai mund ta ndihmoj vetëm një votues në ditën e zgjedhjeve, dhe se asistimi i më shumë se një votuesi është shkelje e Ligjit për zgjedhje ¹¹ .
8.	Të përcaktohet me rregulla përkatëse, që personi që asiston duhet të jetë i moshës 18 vjeç dhe mbi, dhe të ketë letërnjoftim të Republikës së Kosovës. Kjo do t'i evitonte rastet e asistimeve nga personat nën moshën 18 vjeç, dhe gjithashtu asistimin nga personat që nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës.
9.	Pas miratimit të këtij raporti, i njëjti të prezantohet në një tryezë të përbashkët me palët e përfshira në proceset zgjedhore, si OSBE, dhe organizatat jo qeveritare që kanë vëzhguar procesin zgjedhor.

¹¹ Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 89.5, dhe Doracaku i Procedurave të Votimit dhe Numërimit.

SHEMBULL I MIRË

- ✓ Faqe e një libri të votimit: Shënimi (marrja) e të dhënave nga Kryesuesi i Këshillit të Vendvotimit për personat që kanë asistuar dhe për votuesit që kanë votuar me asistencë (Përshirë: emrat, mbiemrat, datat e lindjes dhe numrat personal).



- ✓ Shënimi (marrja) e të dhënave nga Kryesuesi i Këshillit të Vendvotimit për personat që kanë asistuar dhe për votuesit që kanë votuar me asistencë (Përshirë: emrat, mbiemrat, dhe numrat personal).

14. Sadije	-
Ass. Qazim	-
15. Elfiye	-
Ass. Alina	-
16. Shehrije	-
Ass. Arton	-
17. Halit	-
Ass. Zejnepe	-
18. Hamit	-
Ass. Mergim	-
19. Hyra	-
Ass. Sahit	-
20. Sadbere	-
Ass. Sofije Gashi	-
21. Malige	-
Ass. Naser	-

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve | Centralna Izborna Komisija
Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019 | Prevrereni Izbori za Skupstinu Republike Kosovo 2019

Libri i votimit (Libri i Shënimeve në Vendvotim)
Knjiga Glasanja (Knjiga Zapisa sa Biračkog Mesta)

Faqe/ Strana 8 nga 10

SHEMBULL I KEQ

- ✓ Faqe të librave të votimit: Kryesuesi i Këshillit të Vendvotimit, në këtë libër të votimit nuk ka shënuar të dhënat e votuesit që ka votuar me asistencë, ndërsa për personin që ka asistuar, ka shënuar vetëm emrin dhe mbiemrin.

Në ora 14⁰⁵min ka votuar edhe një votues me asistencë, asistuesi ALBERON

Në ora 14¹⁰min ka votuar edhe një votues me asistencë, asistuesi ILIRJANA

Në ora 14¹⁶ ka votuar edhe një votues me asistencë, asistuesi SELVIE

Në ora 14²⁰ ka votuar edhe një votues me asistencë, asistuesi është ARJET

Në ora 14²² ka votuar edhe një votues me asistencë, asistuesi ka qenë Syle

Në ora 14⁴⁵ ka votuar edhe një votues me asistencë, asistuesi SHKËRRIPI

- ✓ Faqe të librave të votimit: Kryesuesi i Këshillit të Vendvotimit, në këtë libër të votimit ka shënuar emrat dhe mbiemrat e votuesit që ka votuar me asistencë, dhe për personat që kanë asistuar, pa të dhëna personale.

22. FITIM	ASISTOJ	HISNI
23. FLORIJE	ASISTOJ	LEONARD
24. ZEKIJE	ASISTOJ	MEKHAT
25. BEGRIE	ASISTOJ	SEJDI
26. SELVETE	ASISTOJ	MARLINDA
27. ENVER	ASIST.	ABDIN
28. FARIJE	ASISTON	BLEDIM
29. FATMIRE	ASISTOJ	SHIRTO
30. SELVETE	ASISTOJ	BEKUST
31. AMIRE	ASISTOJ	XHELAL
32. HAJRIJE	ASISTOJ	FATON
33. SHARRESA	ASISTOJ	ARTON
34. ZYRIJE	ASISTOJ	XHELAL
35. ZAHIRI	ASISTOJ	YHAF
36. QIBRIJE	ASISTOJ	NEGRMANE
37. XHEVALIRE	ASISTOJ	XHAUDET
38. ZILEIJE	ASISTOJ	MEKHID
39. FEXHRIJE	ASISTOJ	BESNIK
40. JEHONA	ASISTOJ	MINEVERE
41. BEGRIJE	ASISTOJ	HALIM

IMAZHE NGA LIBRAT E VOTIMIT

Rasti 1: Personi asiston dy votues në të njëjtin vendvotim:

Në Komunën e Prishtinës:

V. VALDET L. ME NR. ... ASISTOI PËR
HAVA L. ME NR. ...
- VALDET L. ME NR. ... ASISTOI PËR
ZOKI L. ME NR. ...

Në komunën e Rahovecit:

- BENI S. ... NR. ... ASISTOI PËR
ILAZ S. ... NR. ... PO I NJËJTI
ASISTOI PËR PERSONIN E DYTË: FAHRIE ...
... NR. ...

Rasti 2: Personat që kanë asistuar, kanë qenë nën moshën 18 vjeçare:

Në komunën e Prizrenit:

Salije H. ... votoi me asistencë nga
asistente e saj ishte vajza Blerta H. ... 12 vjeçare.
- MIRGENA K. ... 13 VJEET BEN ASISTININ
PËR VOTUESIN - NAGJIBE K. (E CILA
VOTON ME KUSHT).

Rasti 3. Personi që ka asistuar me dokument të huaj (pasaportë të Republikës së Francës)

Në komunën e Prishtinës:

SHERIBANE me nr. të pasaportës (FRANCEZE)
A ka asistuar për FATIME me nr.
personal